



Datë: 03.06.2025
Numër Protokollit: 3760/2025

A.nr.622/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardit Haxhnikaj – Demi -anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 622/2024, të datës 08.04.2025, të parashtruar nga ankuesi Z.A, me përfaqësues juridik avokat Florim Shefqeti, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridik “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa më numër A.nr. 622/2024, e datës 08.04.2025, e parashtruar nga ankuesi Z.A, ashtu që aprovohet pretendimi i ankuesit lidhur me Vendimin MMPHIP114//2025 të datës 18.03.2025 dhe lidhur me konkursin për pozitë Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, ndërsa refuzohet pretendimi ankimor i ankuesit për kompensim material.
- II. Anullohet** Konkursi me Nr. reference: RN00017366 i datës 24.03.2025 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, Vendimi MMPHI-114/2025 i datës 28.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe **Anullohet** pjesa e Raportit të Punës të datës 03.03.2025 me numër rendor 114 që ndërlidhet me propozimet e Komisionit të Ristrukturimit për rekomandimet lidhur me transferimin e ankuesit, ndërsa lëndë kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje** tek organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, të përcaktuar si në pikën **III** të dispozitivit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi Z.A (me tej referuar vetëm ankues), më datë 08.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.622/2025, me pretendimet ankimore për anulimin e Vendimi MMPHI-114/2025 i datës 28.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministritsë së Punëve të Brendshme, Konkursi me Nr. reference: RN00017366 i datës 24.03.2025 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv dhe kompensimin e diferencës së koeficientit sa ishte Udhëheqës i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqës i Divizionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 15.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë ndërsa kjo e fundit, më datë 22.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3290/2025, të datës 20.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 622/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr. 2315/2025 të datës 08.04.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi me numër protokolli 123, i datës 24.02.2014; emali i datës 17.08.2016, dërguar nga M.R, për XH.B; Letër rekomande e datës 19.09.2019; Akt Emërimi i datës 18.11.2016; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2025, dërguar nga R.K, për V.S; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 622/2025, e datës 24.04.2025, Akt Emërimi i datës 07.03.2016, për Z.A; Vendimi për transferim me numër protokolli 01. Nr.119-54063, i datës 07.03.2016, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; kërkesë me numër protokolli 01-119-40701, e datës 19.02.2016; Shkresë zyrtare me numër protokolli 212011, e datës 13.10.2016; Shpallja për avancim për pozitën ‘‘Zyrtar i Lartë Ekzekutiv’’, vendimi me numër protokolli 5689, i datës 03.11.2016, për Themelimin Komisionit intervistues; Dosja e ankuesit Z.V , për pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv lidhur me konkursin me numër RNOO1304, me shkresat e bashkangjitur; Aplikacioni i N.B, me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i V.K, me shkresat e bashkangjitura; Aplikacioni i V.H, me shkresat e bashkangjitura; testet me shikim; Renditja Përfundimtarë; Njoftimi i datës 15.11.2016 , për kandidatin e suksesshëm, për pozitën Zyrtar i lartë Ekzekutiv; Akt Emërimi i datës 18.11.2016, për Z.A; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit me numër protokolli 22.11.2018, për Z.A. Vendimi me numër protokolli 11632, i datës 13.12.2018; Vendimi me numër protokolli 9907, i datës 11.12.2020, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministritsë së Infrastrukturës; emaili i datës 18.05.2023, dërguar nga Z.A, për L.O; emali i datës 08.03.2023, dërguar nga z. A, për F.B.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur së ankesa është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi sipas fillimisht ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 21.03.2016 ka qenë i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor në Ministrinë e Infrastrukturës,

pastaj sipas Akt Emërimit, të datës 18.11.2016, ka qenë i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, tutje sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit, të datës 22.11.2018 mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Zyrës, në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, me gradën 9.

Me tej, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, përmes vendimit me numër protokolli 9907, të datës 11.12.2020, ankuesin, e cakton zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Hartim dhe Harmonizimin të legjislacionit, në Departamentin Ligjor, në afatin gjashtë mujor nga Hyrja në fuqi, e vendimit dhe pas skadimit të afatit kohor ankuesi, kthehet në pozitën sipas Akt Emërimit.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç'rast procesi i organizimit të MMPHI, është pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara.

Në kuadër të përgjegjësiave ligjore, Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ku ky i fundit më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI.

Duke qenë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës janë bashkuar në një ministri, atëherë pozita e ankuesit Zyrtar i lartë Ekzekutiv sipas Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është paraparë Komisioni i Ristrukturimit në MMPHI sipas raportit të datës 03.03.2025, lidhur me rastin e ankuesit ka propozuar që i njëjti të transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

Si rrjedhojë e këtij raporti Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik më datë 28.03.2025 ka nxjerr Vendim me numër MMPHI-114/2025, me të cilin ankuesin e ka transferuar nga pozita Zyrtar i lartë Ekzekutiv në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kërkon që të anulohet Konkursi me Nr. reference: RN00017366 i datës 24.03.2025 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, Vendimi MMPHI-114/2025 i datës 18.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të bëhet kompensimin i diferencës së koeficientit lidhur me pozitën Udhëheqës i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, pozitë e barasvlershme me pozitën e të Udhëheqësit të Divizionit, dhe pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonim të Legjislacionit.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3.*

Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës... , po ashtu Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë se ankuesi pozitën definitive sipas Akt Emërimit, të datës 18.11.2016, e ka mbajtur të Zyrtarit të Lartë Ekzekutiv, në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, atëherë sipas Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kjo pozitë nuk është shuar apo nuk ka pësuar ndryshime, rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit me rastin e propozimit për transferimin e ankuesit nga pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, nuk ka marr fare për bazë se pozita e ankuesit nuk është shuar, dhe sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nuk mund të bëhet transferimi në një pozitë tjetër si pasoj e ristrukturimit kur pozita paraprake që ka mbajtur nëpunësi me akt emërim nuk është shuar, e për rrjedhojë Komisioni i Ristrukturimit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse është bërë propozimi për këtë transferim. Prandaj si rezultat i raportit të ristrukturimit është nxjerr edhe Vendimi MMPHI-114/2025 i datës 18.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilin transferuar nga pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

Andaj, Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit MMPHI-114/2025 të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjeti se i njëjti nuk gjënë mbështetje ligjore për arsye të cekura si më lartë, dhe Kolegji i Këshillit, vendosi që i njëjti të anulohet si në dispozitiv të këtij vendim, po ashtu lidhur me pretendimin ndaj shpalljes së Konkursit me Nr. reference: RN00017366 i datës 24.03.2025 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, Kolegji i Këshillit, konstaton se MMPHI, nuk ka mundur të shpall këtë procedurë pranimit pa përfunduar procesi i shqyrtimit të ankesës së ankuesit, ngase vetë ankuesi në ankesë ka kontestuar shpalljen e këtij konkursi, dhe sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”*, mbi bazë të këtyre rrethanave konkursi i cekur si më lartë është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pretendimi i ankuesit ndaj Vendimit MMPHI-114/2025 të datës 18.03.2025 dhe Konkursit me Nr. reference: RN00017366.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se procedura e ristrukturimit për pozitën të cilës i është nënshtruar ankuesi, është zhvilluar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Shërbimit Civil të përcaktuar sipas të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, andaj Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit të procedurës së propozimit për transferimin e ankuesit duhet të marrë parasysh pikëpamjet e dhëna juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të ketë po ashtu parasysh zbatimin e drejtë të ligjit material. Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e diferencës së pagës për kohën e ushtrimit të pozitës Udhëheqës i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, pozitë e barasvlershme me

pozitën e të Udhëheqësit të Divizionit, dhe pozitës Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonim të Legjislacionit, Kolegji i Këshilli, vlerëson se pretendimi i tillë është i pabazuar ngase duke marr parasysh se sipas Vendimit me numër protokollit 9907, të datës 11.12.2020, ankuesin është caktuar zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Hartim dhe Harmonizimin të Legjislacionit, në Departamentin Ligjor, në afat prej gjashti (6) muaj, atëherë të gjitha pretendimet për kompensim për këtë periudhën janë të pabazuara, sepse sipas këtij vendimi ankuesi nga data 11.06.2021 ligjërisht nuk ka qenë duke e ushtruar këtë pozitë sepse nuk ka ndonjë akt tjetër përmes të cilit ka argumentuar se ka ushtruar tutje këtë pozitë, dhe çështja e kompensimit sipas pretendimeve ankimore të ankuesit, konsiderohet e parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ngase kanë kaluar më shumë se tri (3) vite prej kohën kur ankuesi e ka ushtruar pozitën e pretenduar dhe nuk ka filluar asnjë veprim administrativ.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 622/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Florim Shefqeti;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së